

**PËR AKOMODIMIN E PËRKOHSHËM TË PERSONAVE QË
RIATDHESOHEN SI REZULTAT I SHPALLJES SË GJENDJES SË FATKEQËSISË
NATYRORE PËR SHKAK TË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19**

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe të vendimit nr.311, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdheshohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19”, Komiteti Ndërmintorror i Emergjencave Civile, në zbatim të masave të marra pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore, i mbledhur sot më 17.4.2020,

VENDOSI:

1. Personat e riatdheshuar si rezultat i shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 të akomodohen, përkohësisht, në strukturat akomoduese sipas listës paraprake të evidentuar nga Unioni Turistik Shqiptar (UTSH) dhe Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA), të dakordësuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2. Mbulimin e shpenzimeve të akomodimit të përkohshëm në vlerën 1 700 (një mijë e shtatëqind) lekë për person në ditë nga buxheti i shtetit, fondet e emergjencës, dhe 800 (tetëqind) lekë në ditë nga personi i riatdheshuar, në total 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë për person në ditë, sipas raportit dhe procedurës së ndjekur ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Unionit Turistik Shqiptar (UTSH) dhe Shoqatës Shqiptare të Turizmit (ATA) dhe sipas dokumentacionit që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINTORROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA PARAPRAKE E STRUKTURAVE AKOMODUESE TË EVIDENTUARA

Nr.	Emri hotelit	Vendndodhja Hotelit
1	Hotel “AS”	Golem
2	Hotel “Ibiza”	Golem
3	Hotel “Bonita”	Golem
4	Hotel “Sun”	Durrës
5	Hotel “Gloria”	Golem
6	Hotel “Horizont”	Durrës
7	Hotel “Brilliant”	Golem
8	Hotel “Kolaveri”	Mali i Robit
9	Hotel “Fafa”	Golem
10	Hotel “Eter”	Mali i Robit
11	Hotel “Dolce Vita”	Golem
12	Hotel “Brothers Dijon”	Golem